

Rrjeti për Raportimin e K.O.K.SH

24.09.2024

Rr. Shefqet Musaraj 14, H1, Ap.19,
1001, Tiranë, Shqipëri

Z. Jamarbër Malltezi

I nderuar z. Malltezi,

Rrjeti për Raportimin e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit në Shqipëri (RRKOKSH), po punon për realizimin e një shkrimi mbi akuzat e ngritura nga Prokuroria e Posaçme ndaj kreut të PD-së, Sali Berisha dhe dhëndrrit të tij, z. Jamarbër Malltezi. Ne na kanë lindur disa pyetje, për të cilat lutemi të kemi komentimin tuaj.

Në rast se ne nuk do të marrim asnjë përgjigje nga ju deri të premtën, më datë 27 shtator 2024, ne do e konsiderojmë si fakt që ju refuzoni të komentoni gjetjet e raportimit tonë apo dhe të akuzave të ngrituara nga Prokuroria e Posaçme.

Më konkretisht:

1- Prokuroria e Posaçme, në akuzat e ngritura, ka argumentuar se ka pasur një përpjekje të bashkërenduar mes jush z. Malltezi, z. Fatmir Bektashi e z. Xhimi Begeja, - si përfaqësues të palës pronare e më vonë, sipërmarrës në ish-Kompleksin Partizani - dhe z. Berisha, kreu i qeverisë atë kohë, për të mundësuar kthimin e shpejt, ndërmjet favorizimit me anë të ligjeve të duhura në momentin e duhur - të pronave të pretenduara në 2 Klubet, ndryshimin e destinacionit të tyre për të mundësuar zhvillimin dhe dorëzimin e tyre në dëm të buxhetit të shtetit. Nga verifikimet tona, rezulton se amendimet ligjore me firmën e ish-kryeministrit, njëkohësisht vjerri juaj, kanë dal pikërisht në kohën kur zhvilloheshin procedurat për kthimin dhe privatizimin e ish- Kompleksit Partizani, kur ju keni marr mori tagra përfaqsimi për kthimin, ndryshimin e destinacionit dhe zhvillimin e pronës në fjalë. Besoni se bëhet fjalë për një rastësi?

Referuar dosjes hetimore, familjet pronare Begeja, Llagami, Vaqarri, Saliaga dhe Alimehmeti, pas procesit të njohjes së pronës së tyre në vitet '90, nuk kanë bërë asnjë përpjekje tek institucionet për

kthimin dhe kompesimin e plotë të kësaj prone, - deri në momentin kur vjerri juaj, z. Sali Berisha, nuk ka marr drejtimin e qeverisë, (interesimi i parë daton as një javë pasi PD-ja fitoi zgjedhjet në korrik të 2005), - ku ju rezultoni një nga bashkëptonarët. Z. Malltezi, a janë edhe këto fakte një koncidencë?

Z.Malltezi, në dosjen hetimore të SPAK konstatohet se më 13.01.2006, Ministria e Mjedisit ka informuar ish- familjet pronare të sipërcituara, pas një kërkesë që daton 06.01.2006, se ka rekomanduar privatizimin e Klubit të Futbollit Partizani, që ka nën administrim, bazuar edhe në faktin se objekti nuk përfshihet në planin e zgjerimit të FA. Ndërkohë që, një javë më vonë më 20.01.2006, Komisioni për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave vendosi në favor të kthimit të pronave familjes Begeja.

Si e komentoni faktin se mes këtyre ngjarje, ju keni marr më 13.01.2006 tagra përfaqësimi nga trashëgimtarët e familjës Begeja për negocimin me firma ndërtuese, në një kohë kur zhvillimi i pronës nuk mund të ndodhte në këtë moment pa i ndryshuar destinacionin dhe prona, për aq sa ishit ju në dijeni, ende nuk ishte kthyer formalisht nga KKKP?

4- Z. Malltezi, 10 ditë pasi Këshilli Teknik në Bashkinë Tiranë fillon diskutimet për ndryshimin e destinacionit të fushës sportive të Laprakës, pjesë e ish-Kompleksit Partizani ku ju rezultoni trashëgimtar, është konstatuar nga Prokuroria e Posaçme se keni nënshkruar një kontratë sipërmarrje, duke përfaqësuar palën pronare, me sipërmarrësin firmën Kontakt shpk të z.Fatmir Bektashi, ku qysh në nenin 1 stipulohet se “objekti i kontratës së sipërmarrjes është **kthimi i destinacionit të tokës nga zonë sportive në zonë për ndërtim banesash, privatizim i objekteve ekzistuese dhe bashkepunimi reciprok në fushën e ndërtimit për ndërtimin e një kompleksi shumëfunksional me emer Paschal**”.

Gjithashtu, Kontrata stipulon se:

- Pala pronare vendos në dispozicion të palës sipërmarrëse trualli me sipërfaqje 6345 m2 dhe disa magazina 1-katëshe mbi të.

- Me qëllim ndërrimin sa më parë të destinacionit të zonës, pala pronare vë në dispozicion të palës sipërmarrëse truallin objekt i kësaj kontrate.

- Pala sipërmarrëse pranon të marrë truallin vënë ne dispozicion nga pala pronare dhe të bëjë të gjitha shpenzimet e nevojshme për kthimin e destinacionit të zonës mbi të cilin është vendosur trualli dhe e përfundon këtë proces brenda 3 muajve.

- Pala sipërmarrëse do të ndërtojë në truallin e vënë ne dispozicion një kompleks shumëfunksional me banesa, dyqane, parkime e zyra, leja për të cilin duhet të merret 12 muaj nga nënshkrimi i kontratës.”

Në çfarë mënyre do të arrihej ndryshimi i destinacionit të zonës, i cili duhet të kalonte nëpërmjet amendimeve ligjore domosdoshmërisht, nëse përjashtojmë shfrytëzimin e ndikimit politik të personave të veshur me pushtet?

Si person në kurorë me një person me profesionin avokat, mund të supozohet se ju z. Malltezi duhet të ishit në dijeni të kapërcimeve ligjore që duheshin bërë për arritjen e qëllimeve të kontratës. Në këto kushte, si shpjegohen afatet e ngushta të vendosura aty, nëse jo me pasjen e një avantazhi?

5 - Z. Malltezi, një sërë personash (Andia Pustina, Marin Bicoku, Sali Preci, Kozeta Gëdeshi, Mehmet Kruja, Anila Alite Fetah Hasanaj, Arlind Okaj, Irida Hasa, Florian Pustina etj) - kanë pasur poste në institucione të ndryshme gjatë qeverisë së drejtuar prej vjehrrit tuaj, Z.Sali Berisha, - janë angazhuar në kapacitetet e tyre gjatë procedurave për kthimin, privatizimin dhe zhvillimin e ish-Kompleksit Partizani. Të njëjtët kanë rezultuar më vonë në raporte biznesi me shoqërinë Homeplan shpk, investitore në projektin zhvillimor të pronës, ku ju bëheni aksioner. Koicidencë?

6 - Justina Boriçi, drejtoresha e Agjencinë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave rezultonte një person që militonte në Partinë Demokratike, para se ajo merrte emërimin prej z. Berisha, vjerrit tuaj, në cilësinë e Kryeministrit të . Sipas dëshmive në SPAK të grupit të punës së ngritur, - mes të cilëve persona që kanë rezultuar në raporte kontraktore me ju z. Malltezi, dosja e parë që ky institucion ka shqyruar është ajo e ish-Kompleksit Parizani me kërkesë të grupit të ish - pronarëve ku ju bëni pjesë. Edhe kjo një rastësi z. Malltezi?

7 - Në dosjen e hetimit të SPAK, ju z. Malltezi, rezultoni si përpiluesi i letrës me objekt “Njoftim për keqpërdorim funksioni zyrtar” në emër të 5 familjeve ish-pronare, e cila ngre akuza për korrupsion ndaj z.Vladimir Qiriazit. Kjo letër nuk gjendet e arkivuar në Kryeministri referuar hetimit të SPAK. Kjo letër u përdor nga Zyra Anti-korrupsion në Kryeministri, drejtuar nga vjerri juaj- ku njëri prej inspektorëve të caktuar për verifikim rezulton edhe trashëgimtar me pjesë takuese në ish-Kompleksin Partizani, - për fillimin e kontrollit ndaj punës së z.Qiriazit. A nuk përbënte më së paku konflikt interesi hetimi nga Zyra e Kryeministrit, nën varësinë e z.Berisha, të një ankese të ardhur nga ju, dhëndrri i tij?

Cilat ishin faktet konkrete për korrupsionin e ish-Komandantit Vladimir Qiriazit, për të cilën në letër aludohet, veç mosveprimit të tij në dorëzimin e Klubit?

8 - Nga hulumtimet e Shteg rezulton se më datë 23.01.2014, me anë të kontratës së shitjes së kuotave, Fatmir Bektashi ju shet ju z. Malltezi 35% të kapitalit të kompanisë Homeplan kundrejt cmimit 35.000 lekë dhe 25% të kapitalit në favor të Xhimi Begeja kundrejt cmimit 25.000 lekëve. Por, SPAK pretendon se shitja faktike ka ndodhur në vitin 2018, pas një përpjekje të bërë një vit më parë për të justifikuar dividendin që ju kishit përfituar nga kompania. Dhe në fakt, nga konstatimet tona, rezulton se kontrata e Shitjes së Kuotave në QKB është publikuar në datën 27/12/2018, që përkon me kohën kur organi i akuzës pretendon ka ndodhur shitja e kuotave. Përse është fshehur pronësia juaj mbi Homeplan, nëse jo për fshehje të pasurisë së fituar me mjete joligjore?

9 - Si i gjykoni deklaratat në Prokurorinë e Posacme të z. Fatmir Bektashi, se shoqëria Homeplan shpk është krijuar nga z. Jamarbër Malltezi e z. Xhimi Begeja në 2008 e se ju nuk keni investuar asnjë cent në këtë kompani ndonëse figuroni si investitor?

10 - Po sipas dosjes hetimore, ju akuzoheni se keni përfituar nga viti 2011 deri në likujtimin e shoqërisë Homeplan një shumë të përgjithshme prej 4,657,755 euro, si dhe “1.250,815 euro përfitim njësi shërbimi të marra më tepër se sipërfaqet takuese tek ARA 11-katëshi”. Këto shuma konsiderohen

nga SPAK si mita për ndikimin që ju keni ushtruar te vjerri juaj gjatë procesit të privatizimit të ish-Kompleksit Parizani. Si i justifikoni ju këto përfitime z. Malltezi?

11 - Ndryshimi i dytë i destinacionit të pronave tek ish-Kompleksi Sportiv Partizani, sipas dosjes hetimore, (pasi i pari nuk shtrihej në të gjitha pronat e marra) ka ndodhur në fund të majit 2013, pak javë se PD të dorëzonte pushtetin. Kësaj radhe ju z. Malltezi akuzoheni se keni qënë drejtëpërdrejtë i përfshirë në dhënien e dritës jeshile për ndërrimin e destinacionit, si anëtar i Grupit Strategjik dhe atij Teknik për Miratimin e Planit të Përgjithshëm Vendor të qytetit të Tiranës, ndërsa anëtarë të tjerë të grupit e familjarë kanë prenotuar apartamente në komplekset e ndërtuara mbi atë pronë. Gjithashtu, kur janë detajuar planet vendore për zonën e interesit, ju rezultoni të ketë përpiluar Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis për kompleksin Magnet1.

12 - Në dosjen hetimore rezulton z. Malltezi se gjatë viteve kur vjerri juaj, z. Sali Berisha ka drejtuar qeverinë, ju dhe bashkëshortja juaj keni hyrë në raporte pune me kompanitë të cilave qeveria u kishte dhënë koncesione. Në rastin tuaj Energji Ashta dhe MATI HYDROPOWER dhe në rastine e bashkëshortes suaj, e cila pagahej nga Studio Kola&Associates në vitet 2008-2009, nga kompanitë ASG Poewr, Diekat Ndertim & Konstruksion, Vil Oil, Rompetrol, Unione Eolica Albania, Veve, Stream Oil & Gas Limited. Si i konsideroni këto konstatime të SPAK?

13 - Organi i akuzës ka rënditur disa fakte, nëpërmjet të cilave argumenton se prindrit e bashkëshortes suaj, ish-kryeministri Sali Berisha dhe znj. Liri Berisha, kanë qënë përfitues të zhvillimit të ish-Kompleksit Partizani, aktivitet që ka buruar nga ndryshimet ligjore që z. Berisha pretendohet se ka aktivizuar kur ka qënë krye të detyrës.

Me konkretisht thuhet se çifti Berisha ka përfituar:

- rreth 470 000 Euro e 153 837.61 USD në mbulim shpenzimesh për arsye të ndryshme (shpenzime ligjore për procedet tuaja gjyqësore të hapura jashtë Shqipërisë, shpenzime shëndetësore, pushime etj.), të likujduara prej jush z. Malltezi dhe bashkëshortes suaj;
- rreth 8 599 647.6 Lekë, 24 171 Euro dhe 8 225.89 USD të paguara nga familja juaj për llogari të fondacionit Scaglione, të drejtuar nga vjerra juaj znj. Liri Berisha.

Mendoni se shuma të tilla konsiderohen detyrime normale brenda rrethit familjar, nëse marrim të mirëqënë se akuzat për korrupsion pasiv nuk qëndrojnë?

Web: <https://shteg.org>

